

UDHËZIM

Nr. 36, datë 25.9.2015

PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26 dhe nenit 29 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Kandidati për anëtar i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar i nënshtrohet konkurrimit publik në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

2. Kandidati për anëtar i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar duhet të përmbushë këto kritere:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të jetë i padënuar penalisht, me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- c) të mos jetë në kushtet e konfliktit të interesit;
- d) të mos ketë qenë i ndëshkuar më parë me masa disiplinore të natyrës së pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit;
- e) të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë drejtuese dhe menaxhuese në arsimin parauniversitar, si dhe të ketë përvojë pedagogjike në mesimdhënie;
- f) të zotërojë mirë gjuhën angleze ose një gjuhë tjetër të BE-së (me dëshmi);
- g) të ketë dhënë kontribut prej më shumë se 10 vjetësh në zhvillimin e arsimit parauniversitar nëpërmjet botimeve, studimeve, vëzhgimeve, analizave e raporteve të kryera;
- h) të ketë marrë pjesë në simpoziume, kongrese, konferenca ose në kërkime shkencore brenda ose jashtë vendit në fushën e arsimit parauniversitar.

3. Aplikimi i kandidatit për anëtar të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar të kryhet sipas afateve të shpallura në faqen zyrtare web të MAS-it.

4. Kandidati për anëtar i Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar konkurren me anë të dosjes personale.

5. Dosja e kandidatit për anëtar të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar të përmbajë:

- a) kërkesën;
- b) jetëshkrimin;
- c) diplomën e studimeve universitare dhe/ose pasuniversitare (kopje të noterizuar);
- d) listën e botimeve, vëzhgimeve, studimeve, raporteve dhe kopje të tyre në fushën e arsimit parauniversitar;
- e) tri referenca nga institucione shtetërore ose organizata me të cilat ka bashkëpunuar për çështje të arsimit parauniversitar;
- f) dëshmi penaliteti;
- g) të dhëna mbi punësimin (fotokopje e librezës së punës);
- h) çmime, medalje apo tituj/grada të dokumentuara, të marra në fushën e arsimit parauniversitar.

6. Dosja e kandidatit për anëtar të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar paraqitet në protokollin e MAS-it ose përmes shërbimit postar sipas afatit të shpallur nga MAS.

7. Kandidati për anëtar të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar përzgjidhet nga komisioni i përzgjedhjes të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, i ngritur në MAS.

8. Komisioni harton raportin e vlerësimit të kandidatëve.

9. Komisioni, mbi bazën e vlerësimit të kryer, i propozon ministrit të Arsimit dhe Sportit kandidatët e përzgjedhur për anëtarë të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.

10. Komisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar të respektojë kriterin e barazisë gjinore.

11. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm dhe komisioni i përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla